






Zbatimi i Agjendës së gjelbër dhe vlerësimi i nevojave

Kosovo Green Action



Dhjetor

2024

Përmbajtja

Autore
Sytrime Dervisholli – Hulumtuese

Shkurtesat	3
Përmbledhje ekzekutive	4
1. Hyrje	5
2. Vështrim i Përgjithshëm i Agjendës së Gjelbër	6
3. Çështjet kryesore, nevojat dhe sfidat në energji dhe klimë	8
3.1. Energjia	10
3.2. Klima	15
3.3. Transporti	18
3.4. Ekonomia qarkore	19
3.5. Përfshirja	20
3.6. Menaxhimi i mbeturinave	21
3.7. Uji	22
3.8. Sistemet e qëndrueshme ushqimore dhe zonat rurale	24
3.9. Bujqësia	24
3.10. Biodiversiteti	25
4. Konkluzionet	27

Shkurtesat

ALPEX

BGF

EE

FEE

EGD

PEI

ZRRE

FOL

GHG

ASK

LLOMAG

ME

MMPHI

NDC

SKZH

PKEK

IKP

ODK

BRE

NRMM

Bursa Shqiptare e Energjisë

Balkan Green Foundation

Eficienca e Energjisë

Fondi i Eficiencës së Energjisë

Marrëveshja e Gjelbër Evropiane

Plani ekonomik dhe i investimeve

Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Lëvizja Fol

Emetimet e gazrave serre

Agjencia e Statistikave të Kosovës

Kërkesa në fushat e minierave

dhe të gjenerimit

Ministria e Ekonomisë

Ministria e Mjedisit, Planifikimit

Hapësinor dhe Infrastrukturës

Kontributet e Përcaktuara

Kombëtare

Strategjia Kombëtare për Zhvillim

Plani Kombëtar për

Energji dhe Klimë

Inventari Kombëtar i Pyjeve

Open Data Kosovo

Burimet e Ripërtërishme të Energjisë

Ndërmarrja Rajonale për

Menaxhimin e Mbeturinave

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport ofron një vlerësim gjithëpërfshirës të përparimit të Kosovës në zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, duke u përqendruar në fusha kyçe si energjia, qëndrueshmëria ndaj klimës, menaxhimi i mbeturinave dhe mbrojtja e biodiversitetit.

Agjenda e Gjelbër, e përshtatur me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, përcakton objektiva ambiciozë për dekarbonizimin, ekonominë qarkore, pastrimin nga ndotja dhe sisteme të qëndrueshme ushqimore, me qëllim arritjen e neutralitetit të klimës deri në vitin 2050. Kosova ka bërë avancime të dukshme, por ende përballlet me disa sfida që kërkojnë vëmendje të menjëhershme.

Të gjeturat kyçe:

Kosova ka miratuar Strategjinë e Energjisë 2022–2031 me qëllim që të ofrojë energji të sigurt, të përballueshme dhe të pastër. Qeveria është zotuar të arrijë 1.6 GW kapacitet të energjisë së ripërtërishme dhe të integrojë sistemet e ruajtjes së energjisë deri në vitin 2031.

Zhvillimi i energjisë së ripërtërishme ka përparuar me përfundimin e një ankandi për energjinë solare prej 100 MW dhe një projekt për energjinë e erës prej 150 MW në fazën e zhvillimit. Megjithatë, vendi mbetet ende shumë i varur nga termocentralet që përdorin linjit, të cilët kontribuojnë ndjeshëm në emetimet e gazrave serrë (GHG) dhe ndotjen e ajrit.

Miratimi i Strategjisë së Kosovës për Ndryshimet Klimatike 2019–2028 dhe Ligjit të parë për Ndryshimet Klimatike në vitin 2024 shënon një hap të rëndësishëm drejt adresimit të ndikimeve klimatike. Strategjia përshkruan masat zbutëse dhe përshtatëse që synojnë reduktimin e emetimeve nga GHG-të dhe rritjen e qëndrueshmërisë ndaj klimës.

Emetimet e GHG-ve në Kosovë kanë shënuar një rritje të vazhdueshme, me 75% të emetimeve në vitin 2020 që vijnë nga sektorët e furnizimit me energji elektrike, gaz dhe ajër të kondicionuar. Vendi përballlet me sfida në arritjen e objektivave të veta klimatike për shkak të përdorimit të teknologjive të vjetruara dhe konsumit të lartë të energjisë në ndërtesat me efikasitet të ulët energjetik.

Kosova miratoi Udhërrëfyesin e Ekonomisë Qarkore në vitin 2023 duke vendosur themelet për kalimin në një model ekonomik të qëndrueshëm. Megjithatë, infrastruktura e menaxhimit të mbeturinave mbetet e pazhvilluar, me boshllëqe të konsiderueshme në riciklim,

menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme dhe zbatimin e rregulloreve.

Ligji për Mbeturinat është miratuar në vitin 2022, por zbatimi ka qenë i ngadaltë. Të dhënat e kufizuara për mbledhjen, klasifikimin dhe trajtimin e mbeturinave pengojnë përparimin e mëtejshëm.

Kosova është një vend i pasur me biodiversitet, me rreth 45% të territorit të mbuluar nga pyjet. Vendi ka shënuar përparime të rëndësishme në ruajtjen e natyrës, duke krijuar 260 zona të mbrojtura që mbulojnë 11.6% të sipërfaqes së vet.

Megjithatë, ka një mungesë të të dhënave sistematike për mbrojtjen e specieve, habitatet e rrezikuara dhe efektivitetin e përpjekjeve të qëndrueshme për ruajtjen e tyre.

Kosova përballlet me sfida të mëdha në lidhje me ndotjen e ujit dhe të ajrit. Vetëm 65% e popullsisë është e lidhur me shërbimet e kanalizimit, ndërsa uji i papërpunuar shpesh derdhet në lumenj, duke paraqitur rreziqe për mjedisin dhe shëndetin publik.

Ndotja e ajrit, veçanërisht në Prishtinë, mbetet një çështje kritike për shkak të varësisë nga thëngjilli dhe përdorimit të sistemeve joefikase të ngrohjes së shtëpive.

Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në avancimin e objektivave të Agjendës së Gjelbër, veçanërisht në fushat e tranzicionit të energjisë dhe të legjisllacionit mjedisor. Megjithatë, mbeten sfida të konsiderueshme, përfshirë infrastrukturën e vjetruar, mbledhjen e pamjaftueshme të të dhënave dhe mungesën e politikave sektoriale.

Për të përshpejtuar përparimin, Kosova duhet:

1. Ta forcojë koordinimin ndërsektorial dhe aftësitë institucionale
2. Të investojë në modernizimin e infrastrukturës për energjinë e ripërtërishme dhe menaxhimin e mbeturinave.
3. Të përmirësojë sistemet për mbledhjen e të dhënave për një monitorim dhe raportim më të avancuar mbi ndikimet mjedisore.
4. Të rritë ndërgjegjësimin dhe angazhimin e publikut në veprimet klimatike për të siguruar një të ardhme më të qëndrueshme.

Ky raport është hartuar në kuadër të projektit “Projekti i Veprimit të Gjelbër për Kosovën”, i cili synon përmirësimin e qasjes në të dhënat klimatike dhe energjetike në Kosovë përmes krijimit të një platforme të dedikuar në internet për Agjendën e Gjelbër. Kjo platformë ofron një burim të centralizuar për palët e interesuara për të pasur qasje dhe ndarë informacione kyçe lidhur me zbatimin e Agjendës së Gjelbër, duke përmirësuar kështu transparencën dhe nxitur bashkëpunimin.

Projekti përfshin një gamë të gjerë akterësh në një përpjekje të përbashkët për përgjegjësinë sociale, duke u fokusuar në prioritetet klimatike dhe energjetike të përshkuara në Agjendën e Gjelbër të miratuar nga BE-ja për Ballkanin Perëndimor. Ai është në përputhje me shtyllat kryesore të Agjendës, duke promovuar qasjen në informacion, përmirësuar qeverisjen, siguruar llogaridhënie dhe transparencë brenda institucioneve qeveritare dhe fuqizuar të rinjtë për t’u angazhuar në aktivitete klimatike. Një nga nismat kryesore të projektit, “Forumi i Gjelbër”, shërben si një platformë interaktive për mbledhjen e komenteve dhe rekomandimeve për zbatimin e Agjendës së Gjelbër.

I nisur më 16 shkurt 2023, ky projekt udhëhiqet nga Balkan Green Foundation (BGF) në bashkëpunim me Open Data Kosovo (ODK) dhe Lëvizja FOL (FOL). Qëllimi i tij është të mbështesë tranzicionin e Kosovës drejt qëndrueshmërisë klimatike dhe energjetike, duke adresuar çështje të rëndësishme në eficiencën energjetike, promovimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe detyrimet e përgjithshme mjedisore të vendit.

Për të ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse të progresit të Kosovës në zbatimin e Agjendës së Gjelbër është miratuar një qasje me metoda të përziera. Kjo qasje përfshin intervista sy më sy me akterët kryesor dhe hulumtim të gjerë në zyrë. **Intervistat sy më sy** lejuan mbledhjen e njohurive të drejtpërdrejta, duke adresuar sfidat, nevojat dhe mundësitë specifike në zbatimin e politikave klimatike dhe energjetike. Këto intervista dhanë këndvështrime të thelluara mbi realitetet operative të prezantimit të Agjendës së Gjelbër dhe mundësuan sqarimin e të gjitha paqartësive, duke pasuruar kështu cilësinë e përgjithshme të të dhënave të mbledhura. Paralelisht, **hulumtimi në zyrë** u krye për të kontekstualizuar gjetjet dhe për të mbështetur analizën me informacione bazë nga literatura ekzistuese, dokumentet e politikave dhe raportet. Ky hulumtim

ndihmoi në identifikimin e praktikave më të mira, të boshllëqeve të politikave dhe fushave ku mekanizmat aktualë mund të forcohen për të përshpejtuar tranzicionin drejt synimeve klimatike të Kosovës.

Ky raport paraqet një vlerësim të detajuar të progresit aktual të Kosovës dhe sfidave me të cilat përballet në zbatimin e Agjendës së Gjelbër. Raporti fillon me një pasqyrë të Agjendës së Gjelbër dhe shqyrton kornizën legjislative dhe të politikave që udhëzojnë veprimet e Kosovës në sektorët e energjisë dhe klimës.

Janë shqyrtuar sfidat kryesore që lidhen me dekarbonizimin, tranzicionin e energjisë dhe qëndrueshmërinë klimatike, duke theksuar pengesat që e kufizojnë aftësinë e Kosovës për të arritur objektivat e veta klimatike. Raporti trajton strategjitë për të reduktuar emetimet e GHG-ve, për të intensifikuar përpjekjet për përshtatjen me ndryshimet klimatike dhe për të rritur eficiencën energjetike. Gjithashtu vlerëson përpjekjet e Kosovës për një ekonomi qarkore, praktikatat dhe iniciativat për menaxhim të mbeturinave për të eliminuar ndotjen e ajrit, të ujit dhe tokës.

Ky vlerësim shqyrton më tej iniciativat specifike sektoriale, si promovimi i transportit të qëndrueshëm, dhe ofron një analizë të tendencave klimatike dhe të strategjive zbutëse. Po ashtu, në të shqyrtohen përpjekjet për të forcuar qëndrueshmërinë e infrastrukturës energjetike të Kosovës, veçanërisht në drejtim të adaptimit të energjisë së ripërtërishme dhe reduktimit të varësisë nga thëngjilli.

Duke identifikuar çështjet kritike, nevojat dhe sfidat që lidhen me zbatimin e Agjendës së Gjelbër, ky raport ofron një pasqyrë vepruese se si Kosova mund të përmirësojë politikatat e energjisë dhe të mjedisit. Adresimi i këtyre sfidave do t’i mundësojë Kosovës të rrisë eficiencën energjetike, të përshpejtojë adaptimin e energjisë së ripërtërishme dhe të forcojë përshtatshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike, duke pozicionuar vendin si lider në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit në rajon.

Vështrim i Përgjithshëm i Agjendës së Gjelbër 2

Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor është një plan për arritjen e neutralitetit klimatik dhe të qëndrueshmërisë ekologjike deri në vitin 2050. Kjo agjendë, e bazuar në pesë shtylla, është në pajtim me ambiciet e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane dhe mbështetet në reforma të domosdoshme rregullatore dhe investime të mëdha. Pesë shtyllat kryesore të kësaj agjende janë:

- I. Dekarbonizimi dhe qëndrueshmëria klimatike
- II. Ekonomia qarkore
- III. Eliminimi i ndotjes së: ajrit, ujit dhe tokës
- IV. Sistemet e qëndrueshme ushqimore dhe zonat rurale
- V. Biodiversiteti: mbrojtja dhe restaurimi i sistemeve

Plani Ekonomik dhe i Investimeve (PEI) promovon zbatimin e Agjendës nëpërmjet katër pikave kryesore që shtrihen në një ose më shumë shtylla. Ato i referohen:

- Mjedisit dhe klimës
- Energjisë së pastër
- Transportit të qëndrueshëm
- Zhvillimit të sektorit privat

Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, e hartuar në bashkëpunim ndërmjet rajonit dhe Bashkimit Evropian, u miratua si pjesë e Planit Ekonomik dhe Investues për Ballkanin Perëndimor dhe u mbështet nga liderët e rajonit në Deklaratën e Sofjes në nëntor 2020¹.

Plani i Veprimit i Agjendës së Gjelbër² përshkruan kornizën për koordinimin dhe monitorimin e tij, ndërsa përgjegjësia kryesore për zbatimin i takon autoriteteve të Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet bashkëpunimit ndërsektorial dhe ndërinstytucional. Plani i Veprimit merr parasysh proceset kryesore politike, kornizat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, zhvillimet më të fundit në politikë, si dhe veçanërisht aktet legjislativ dhe jolegislativ të miratuara në nivelin e BE-së. Këto përfshijnë: **Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane ((EGD)**, Kornizën Klimatike të BE-së, Strategjinë e BE-së për

Biodiversitetin, Strategjinë e BE-së “Nga Ferma në Pirun”, Paketën “e Përshtatshme për 55%”, Planin e Veprimit për Zero Ndotje, etj.), objektivat dhe ambiciet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2030, në përputhje me objektivat afatmesme klimatike të BE-së për reduktimin e emetimeve GHG për të paktën 55%, si dhe shumë të tjera³.

Kosova ka ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm në zbatimin e Agjendës së Gjelbër, duke hartuar ligje dhe strategji që fokusohen në efikasitetin energjetik, ndryshimet klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Këto përpjekje bazohen në një kombinim të ligjeve kryesore dhe dokumenteve strategjike, të cilat së bashku e ndihmojnë vendin të ecë drejt një të ardhmeje më miqësore ndaj mjedisit.

Në aspektin ligjor, Kosova ka miratuar legjislacion që mbulon fusha të rëndësishme, si efikasiteti energjetik, rregullimi i energjisë elektrike dhe promovimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë (BRE). Këto ligje ndihmojnë në sigurimin e nevojave energjetike të vendit, duke reduktuar njëkohësisht ndotjen.

Në të njëjtën kohë, Kosova ka krijuar strategji që funksionojnë në përputhje me këto ligje. Këto strategji përcaktojnë qëllime dhe plane veprimi të qarta për qëndrueshmërinë afatgjate dhe zhvillimin ekonomik.

¹ Komisioni Evropian. Zbatimi i Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. 2023. Burimi: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/75bf7bef-0ecc-40ba-893a-4d45d4ea6ddb_en?filename=factsheet_wb_green_agenda_en.pdf

² Këshilli për Bashkëpunim Rajonal: Plani i Veprimit për Zbatimin e Deklaratës së Sofjes mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor 2021–2030. Burimi: <https://www.rcc.int/docs/596/action-plan-for-the-implementation-of-the-sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkans-2021-2030>

³ Këshilli për Bashkëpunim Rajonal. Plani i veprimit për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. 2021. Burimi: <https://www.rcc.int/docs/596/action-plan-for-the-implementation-of-the-sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkans-2021-2030>

Tabela më poshtë përmbledh ligjet kryesore dhe dokumentet strategjike që po i shtynë përpjekjet e Kosovës për zbatimin e Agjendës së Gjelbër.

Tabela 1: Ligjet dhe strategjitë kryesore që mbështesin zbatimin e Agjendës së Gjelbër në Kosovë

Legjislacioni primar	Dokumentet strategjike
Ligji për Eficiencë të Energjisë	Strategjia kombëtare për zhvillim 2030
Ligji për Pajisjet nën Presion	Strategjia e Energjisë 2022–2031
Ligji për Energjinë Termike	Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019–2028
Ligji për Rregullatorin e Energjisë	Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike 2019–2021
Ligji për Energjinë Elektrike	Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) (versioni i parë i draftit)
Ligji për Energjinë	Strategjia për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030
Ligji për Gazin Natyror	Udhërrëfyti për Ekonomi Qarkore 2023
Ligji për Performancën Energjetike në Ndërtesa	Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit
Ligji Për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë	Strategjia e Transportit Multimodal 2023–2030
Ligji për Organizimin e Tregut për Produktet Bujqësore	
Ligji për Ndryshimet Klimatike	
Draft Ligji për Mbrojtjen e Natyrës	
Draft Ligji për Ujërat e Kosovës	

Përdorimi i Kosovës ka miratuar ligje dhe strategji gjithëpërfshirëse për të mbështetur Agjendën e Gjelbër, zbatimin mbetet i paqëndrueshëm. Sfidat kryesore përfshijnë burimet e kufizuara financiare, kapacitetin e pamjaftueshëm institucional dhe mekanizmat e dobët të zbatimit.

Progresi

- >Ligji për Eficiencë të Energjisë – Përmirësime në rinovimin e ndërtesave publike,
- >Strategjia për Ndryshimet Klimatike (2019–2028) – Miratimi i masave zbutëse dhe përshtatëse,
- >Udhërrëfyti për Ekonomi Qarkore (2023) – Një hap themelor drejt qëndrueshmërisë.

Boshllëqet dhe problemet


- >Kufizimet financiare – Buxhetet e kufizuara të alokuara për projektet mjedisore pengojnë përmirësimin e infrastrukturës, përfshirë impiantet e menaxhimit të mbeturinave dhe sistemet e energjisë së ripërtërishme,
- >Ngritja e kapaciteteve – Institucioneve komunale u mungojnë trajnimet dhe ekspertiza për zbatimin efektiv të ligjit,

>Monitorimi dhe llogaridhënia – Mekanizma të dobët për monitorimin e progresit dhe zbatimin e pajtueshmërisë me legjislacionin.

Rekomandimet

- >Të forcohen më tej mekanizmat e monitorimit për zbatimin e strategjive dhe të identifikohen pengesat,
- >Alokimi i fondeve të dedikuara për sektorët prioritarë, siç janë menaxhimi i mbeturinave dhe energjia e ripërtërishme,
- >Organizimi i programeve trajnuese për stafin komunal dhe palët e interesuara për ndërtimin e kapaciteteve në zbatimin e ligjit dhe politikave.

3. Çështjet kryesore, nevojat dhe sfidat në energji dhe klimë



Zyra e Kryeministrit (ZKM) ka një rol koordinues për iniciativat dhe angazhimet e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës në kuadër të integritimit në Bashkimin Evropian, përfshirë negociatat për Agjendën e Gjelbër. Në këtë kontekst, ministrinë përkatëse përgjegjëse për sektorët e tyre marrin përsipër detyrimet përkatëse. Detyrimet e renditura më poshtë i përkasin Ministrisë së Ekonomisë (ME) dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).

Tabela 2 përshkruan zotimet kryesore të ndërmarra nga ME në lidhje me Agjendën e Gjelbër të Kosovës, duke detajuar veprimet e planifikuara, statusin aktual dhe afatet kohore për zbatimin e tyre.

Tabela 2: Zotimet e ME-së për zbatimin e Agjendës së Gjelbër

Zotimet	Detajet	Statusi/Afati kohor
Zbatimi i Strategjisë së Energjisë	Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë së Energjisë 2022–2031, në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, duke siguruar konsistencën me draft-Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK).	Miratuar; zbatimi është në vazhdim e sipër.
Korniza Ligjore për Energjinë e Pastër	Krijimi i një kornize ligjore për të adresuar sfidat për një peizazh të energjisë së pastër (Ligji për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë).	I miratuar në T2/2024; i përfunduar.
Ankandet për Energjinë e Ripërtërishme	Organizimi i ankandeve transparente dhe konkurruese për investimet në BRE. Përfundimi i ankandit solar prej 100 MW dhe identifikimi i vendndodhjeve për projektet e energjisë së erës dhe asaj solare.	Ankandi solar 100 MW është përfunduar (T1/2024); ankande të tjera janë në vazhdim.
Projekti për bateritë për ruajtje të energjisë	Bashkëpunimi në projektin për bateritë për ruajtje të energjisë financuar nga Llogaria e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCA).	Në vazhdim
Projekti për Energjinë e Erës me kapacitet 150 MW	Nisja e një projekti për energjinë e erës me kapacitet 150 MW, i financuar nga Fondi i FMN-së për Reziliencën dhe Qëndrueshmërinë (RSF), sipas një skeme të Partneritetit Publiko-Privat (PPP).	Në vazhdimi, projektet e suksesshme do të fitojnë një marrëveshje 15-vjeçare për blerjen e energjisë.
Projekti për Energjinë Solare me kapacitet 100 MW	Zbatimi i projektit të energjisë solare me kapacitet prej 100 MW, në përputhje me marrëveshjen për zhvillimin e projektit, duhet të përfundojë brenda dy viteve nga nënshkrimi i kontratës.	Projekti do të vihet në funksion brenda dy viteve nga nënshkrimi i marrëveshjes.

Tabela 3 përmbledh zotimet e marra nga MMPHI, duke përshkruar veprimet kryesore që synojnë përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, cilësisë së ajrit, menaxhimit të mbeturinave dhe strategjive për ndryshimet klimatike. Çdo veprim ka një afat kohor për përfundimin ose zbatimin e tij.

Tabela 3: Zotimet e MMPHI për mbrojtjen e mjedisit dhe klimës

Zotimet	Detajet	Statusi/Afati kohor
Ligji për Mbrojtjen e Natyrës	Finalizimi dhe miratimi i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës.	Pritet deri në T4/2024.
Ligji për Ujërat e Kosovës	Miratimi i Projektligjit për Ujërat e Kosovës.	Pritet deri në T4/2024.
Plani i Veprimit për Cilësi të Ajrit	Miratimi dhe zbatimi i Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit.	Pritet deri në T4/2024.
Masat për kontrollin e ndotjes së ajrit	Projektimi i masave për kontrollin e ndotjes së ajrit në Prishtinë dhe në zona të tjera të ndjeshme.	Pritet deri në T2024/4.
Plani për kapacitetet e menaxhimit të mbeturinave	Zhvillimi dhe fillimi i zbatimit të një plani për përmirësimin e kapaciteteve institucionale në zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave.	Pritet deri në T4/2024.
Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbeturinave	Ndryshimi i strategjisë për të përfshirë objektivat e riciklimit, menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme dhe bashkëpunimin ndërkomunal.	Pritet deri në T4/2024.
Direktivat e BE-së për rrjedhat e mbeturinave	Transpozimi i direktivave të BE-së për rrjedhën e mbeturinave në legjislacionin e Kosovës.	Pritet deri në T4/2024.
Fushatat për ndërgjegjësim të publikut	Organizimi i fushatave të vazhdueshme të ndërgjegjësimit publik për çështjet e mbrojtjes së mjedisit.	Në vazhdim e sipër; faza e parë T4/2023.
Strategjia për Ndryshimet Klimatike	Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit për ndryshimet klimatike.	Në vazhdim e sipër
Inventari për gazrat serrë	Përgatitja e një inventari për emetimet e GHG-ve deri në vitin 2021.	I përfunduar në T2/2023.
Objektivat e Riciklimit dhe Menaxhimi i Mbeturinave	Ndryshimi i strategjisë kombëtare për menaxhimin e mbeturinave për riciklimin dhe menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme.	Pritet deri në T4/2024.
Transpozimi i legjislacionit të BE-së për mbeturinat	Transpozimi i direktivave të BE-së për rrjedhën e mbeturinave në ligjin kombëtar.	Pritet deri në T4/2024.

Sigurimi i energjisë së sigurt, të përballueshme dhe të pastër është thelbësor për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe mirëqenien sociale të qytetarëve të saj. Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar të zbatojë një qasje të re në planifikim, për të adresuar sfidat aktuale dhe për të ndërtuar themelet për të ardhmen e sektorit energjetik të vendit, që do të sigurojë gjithnjë e më shumë siguri në furnizimin me energji elektrike, energji të pastër, eficiencë energjetike dhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve, si dhe mbështetje për grupet e cënueshme. Sistemi elektro-energjetik i Kosovës do të integrohet në tregun rajonal dhe pan-evropian, ndërsa pavarësia e tij do të sigurohet gradualisht përmes BRE-ve.

Integrimi i tregut me Republikën e Shqipërisë është një prioritet i lartë dhe veçanërisht i rëndësishëm për Kosovën. Hapi i parë më i rëndësishëm në këtë drejtim ishte funksionalizimi i plotë i Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), që u realizua në vitin 2023, e ndjekur nga integrimi i mëtejshëm në tregun rajonal dhe pan-evropian deri në vitin 2030.

Për shkak të mungesës së një qasjeje adekuate për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe investimeve të duhura gjatë dekadave të fundit, **sektori energjetik i Kosovës tani po përballlet me sfida të mëdha**, duke përfshirë:

>Varësia nga kapacitetet e vjetra të prodhimit të energjisë elektrike, të cilat bazohen në linjit, të cilat nuk ofrojnë siguri dhe fleksibilitet të mjaftueshëm dhe janë burimi kryesor i emetimeve GHG dhe ndotjes lokale. Aktualisht, pjesa e burimeve të ripërtërishme (BRE) në sektorin e energjisë elektrike është vetëm 6.3%, ku BRE-të në këtë sektor dominohen nga burimet e bazuara në biomasë që përdoren për ngrohje.

>Konsumi i lartë i energjisë (dhe, rrjedhimisht, shpenzimet e lidhura me energjinë) në raport me BPV-në dhe popullsinë, për shkak të një sërë faktorësh, duke përfshirë humbjet e larta të rrjetit dhe përdorimin e ndërtesave joefikase si dhe teknologjive të vjetruara në sektorët e banimit dhe atij komercial (përfshirë ngrohjen e hapësirës dhe ujit).

>Varësia e madhe nga sistemet individuale të ngrohjes shtëpiake, të bazuara në energji elektrike ose pajisje joefikase për djegien e qymyrit ose drurit, çon në një rritje të ndjeshme të nevojës për importin e energjisë elektrike dhe emetimeve të larta të GHG-ve, si dhe ndotjes së ajrit gjatë muajve të ftohtë.

Përqendrimi i lartë i tregut në të dy nivelet e shitjes me shumicë dhe pakicë do të jetë vendimtar për mbështetje të përpjekjeve më të gjera të Kosovës në përmirësimin e eficiencës energjetike, reduktimin e emetimeve të GHG-ve dhe rritjen e pjesës së energjisë së ripërtërishme në përzierjen e përgjithshme të energjisë.

3.1 Energjia

Kosova ka miratuar **Strategjinë e Energjisë 2022–2031**⁴. Kosova është zotuar të ofrojë energji të sigurt, të përballueshme dhe të pastër për të siguruar zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve të saj, duke e vendosur këtë si një prioritet në të ardhmen e saj energjetike. Qeveria ka për qëllim të arrijë një kapacitet prej 1.6 GW nga energjia elektrike e ripërtërishme dhe të prezantojë bateri me kapacitet total prej 340 MWh deri në vitin 2031. Gjithashtu, është vendosur të rinovohet të paktën një bllok i Termocentralit Kosova A dhe dy blloqe të Termocentralit Kosova B.

Sipas **Raportit të Progresit për vitet 2022–2023 për zbatimin e Strategjisë së Energjisë**⁵, mund të vlerësohen këto arritje:

⁴ Ministria e Ekonomisë. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022–2031. Burimi: <https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Energy-Strategy-of-the-Republic-of-Kosovo-2022-2031-I-1.pdf>

⁵ Raporti i Progresit për 2022 – 2023 i Programit për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022–2025. Burimi: https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/05/Raporti-i-progresit-te-Zbatimit-te-PZSEK-se-2022-2023_ENG.pdf

Tabela 4: Arritjet kryesore në zbatimin e Strategjisë Energjetike të Kosovës (2022–2023)

Kategoria	Të arriturat në vitin 2022	Të arriturat në vitin 2023
Investimet në Rrjetin e Shpërndarjes	– Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe zvogëlimi i humbjeve në rrjet. – Instalimi i njehsorëve të energjisë elektrike për një matje dhe faturim më të saktë.	– Fuqizimi i rrjeteve të tensionit të mesëm dhe të ulët, të cilat janë konvertuar nga 10kV në 20kV. – Përmirësimet të mëtejshme në saktësinë e matjeve dhe faturimit.
Përmirësimet në teknologjinë informative (TI).	– Përmirësimi i mbrojtjes së të dhënave, sigurisë kibernetike dhe produktivitetit të kompanisë përmes investimeve në TI.	– Vazhdimi i investimeve në TI për rrjetin e shpërndarjes, duke përmirësuar mbrojtjen e të dhënave dhe besueshmërinë e sistemit.
Efiçienca e Energjisë (EE)	– Masat e zbatuara të EE në ndërtesat publike, duke kursyer 0.78 ktoe/vit. – Zgjerimi i përpjekjeve për Efiçencë Energjetike (EE) në 26 ndërtesa banimi, me kursime të pritshme deri në 30%.	– Arritja e kursimit të 1.67 ktoe/vit të energjisë në ndërtesat publike. – Vazhdimi i mbështetjes për Efiçencën Energjetike (EE) për familjet dhe ato në nevojë.
Spektori i Ngrohjes	– Zgjerimi dhe rehabilitimi i 17,834 metrave të tubacioneve në rrjetin e ‘Termokosit’. – Instalimi i kohëmatësve dhe rindërtimi i 355 nënstacioneve në Gjakovë.	– Vazhdimi i rehabilitimit dhe zgjerimit të rrjetit të ngrohjes qendrore në Prishtinë. – Modernizimi i sistemit të ngrohjes në Gjakovë dhe lidhja e ndërtesave të reja publike në të.
Mbështetje për konsumatorët e cënueshëm	– Sigurimi i subvencioneve për familjet në nevojë dhe mbështetje për faturat e energjisë elektrike.	– Vazhdimi i subvencioneve për familjet e cënuara dhe mbështetja për faturat e energjisë elektrike.
Infrastruktura Ligjore dhe Politike	N/A	– Janë aprovuar disa akte nënligjore, duke përfshirë: – Udhëzimin Administrativ nr. 01/2023 (Promovimi për përdorimin e BRE-ve) – Udhëzimin Administrativ nr. 02/2023 (Caket BRE) – Legjislacioni dytësor për prosumatorët.

Arritja e objektivave për vitin 2022 ishte 73.7%, ndërsa për vitin 2023 ishte 51.8% ⁶.

Tab 5: Arritjet e objektivave 2022–2023:

	2022	2023
Objektivi 1 – Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit	59.2%	51.8%
Objektivi 2 – Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtërishme	68.3%	51.3%
Objektivi 3 – Rritja e eficiencës së energjisë	62.8%	51.0%
Objektivi 4 – Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut	80.0%	60.0%
Objektivi 5 – Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve	98.0%	45.0%
Totali	73.7%	51.8%

Burimi: Raporti i Progresit për vitet 2022–2023 për zbatimin e Strategjisë së Energjisë

Të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, kanë vendosur objektiva afatgjata për energjinë dhe klimën në Kontributet e Përcaktuara Kombëtare (KPK), strategjitë e qeverisë ose dokumentet e tjera përkatëse.

Tabela 6: Objektivat për energjinë dhe klimën për Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2030

Pala kontraktuese	Objektivi i pjesës së energjisë nga burimet e ripërtërishme në konsumin final bruto të energjisë, për vitin 2030.	Pjesa maksimale e konsumit të energjisë primare në vitin 2030. (Mtoe)	Pjesëmarrja maksimale në konsumin final të energjisë në vitin 2030	Objektivi për emetimet neto të GHG-ve në krahasim me nivelet e vitit 1990 dhe emetimet absolute në vitin 2030
Shqipëria	%52.0	2.60 Mtoe	2.40 Mtoe	+53.2% 12.00 MtCO ₂ eq
Bosnja dhe Hercegovina	%43.6	6.50 Mtoe	4.34 Mtoe	-41.2% 15.65 MtCO ₂ eq
Kosova	%32.0	2.70 Mtoe	1.80 Mtoe	-16.3% 8.95 MtCO ₂ eq
Mali i Zi	%50.0	0.92 Mtoe	0.73 Mtoe	-55.0% 2.42 MtCO ₂ eq
Maqedonia Veriore	%38.0	2.30 Mtoe	2.00 Mtoe	-82.0% 2.20 MtCO ₂ eq
Serbia	%40.7	14.94 Mtoe	9.54 Mtoe	-40.3% 47.82 MtCO ₂ eq

Burimi: Komuniteti i Energjisë

Mbi 70 projekte në fushën e **eficiencës energjetike** janë përgatitur nga Fondi për Efikasitetin e Energjisë (FEE) dhe pritet të realizohen në bashkëpunim me komunat e Kosovës. Shembulli i mirë për këtë është projekti për zbatimin e masave të eficiencës së energjisë në objektet sociale shumë-banesore gjatë vitit 2023. Pas procesit të përzgjedhjes, janë zgjedhur gjithsej 31 objekte të banimit social në 14 komuna të Republikës së Kosovës⁷.

Në vitin 2023, furnizimi me energji elektrike u prodhua kryesisht nga termocentralet, me një vlerë prej 5,859,662 GWh. Vendi importoi 1,238.3 GWh energji elektrike, ndërsa eksportoi 241.3 GWh, duke rezultuar në një konsum total energjie prej 1,577.9 ktoe.

⁷ Tre në Skenderaj, 1 në Malishevë, 2 në Drenas, 2 në Gjiilan, 1 në Istog, 2 në Obiliq, 3 në Kamenicë, 2 në Suharekë, 3 në Viti, 4 në Prishtinë, 2 në Klinë, 2 në Mitrovicë, 1 në Lipjan dhe 3 in Prizren.

Për qëllim krahasimi, në vitin 2022 kërkesa totale për energji ishte 6,547 GWh. Zbërthimi i shifrave për vitin 2022:

Prodhimi: 6,147 GWh nga gjeneratorët e transmisionit dhe 168 GWh nga gjeneratorët e shpërndarjes.

Importi: 761 GWh, duke e çuar totalin e energjisë në dispozicion në 7,076 GWh.

Eksporti: 787 GWh, me një bilanc neto import/eksport prej 26 GWh.

Devijimet e sistemit: Nga sistemi janë hequr 186 GWh, ndërsa për transit janë përdorur 2,475 GWh.

Kërkesa: Kërkesa në nivel vendor arriti në 6547 GWh.

Humbjet: Humbjet në transmision arritën në 118 GWh, ndërsa në shpërndarje arritën në 1,403 GWh.

Konsumi: Konsumatorët në rrjetin e transmisionit konsumuan 132 GWh, ndërsa konsumi i LLOMAG–ut ishte 101 GWh dhe ngarkesa në rrjetin e shpërndarjes arriti 6,196 GWh, me një konsum neto në sistemin e shpërndarjes prej 4,794 GWh.

Tabela 7: Ngarkesa maksimale Pmax (MW)

Ngarkesa maksimale Pmax (MW)	Data	Koha
1,429	24.01.2022	23:00
1,389	26.01.2022	23:00
1,375	13.01.2022	18:00
1,349	22.01.2022	24:00
1,341	12.01.2022	19:00

Burimi: Zyra e Rregullatorit për Energji, Raporti Vjetor 2022

Në vitin 2023, prodhimi i linjitit arriti në 6,924 milionë tonë, ndërsa konsumi arriti në 7,437 milionë tonë. Të dyja shifrat ishin më të ulëta se në vitin 2022⁸.

Prodhimi nga Burime të Ripërtërishme të Energjisë (BRE), i lidhur me rrjetin e transmisionit, arriti në 581.2 GWh gjatë vitit 2023, duke reflektuar një rritje prej 23.8% krahasuar me vitin 2022. Ndërkohë, prodhimi i BRE–ve të lidhura me rrjetin e shpërndarjes ishte 186.4 GWh, që përfaqëson një rritje prej 11.12% krahasuar me vitin e kaluar⁹.

Sa i përket funksionimit të termocentraleve në vitin 2023, blloqet B1 dhe B2 kanë funksionuar afërsisht 70% të kohës, ndërsa blloqet A3, A4 dhe A5 kanë funksionuar përkatësisht me 62%, 76% dhe 52%. Për krahasim, blloqet B1 dhe B2 funksionuan rreth 86% të kohës në vitin 2022 dhe 84% në vitin 2021¹⁰.

Sa i përket prodhimit të energjisë elektrike, në vitin 2023 prodhimi për kokë banori ishte 3,823 kWh, duke shënuar një rënie krahasuar me 4,163 kWh në vitin 2022. Prodhimi total i energjisë elektrike në vitin 2022 arriti në 6.91 TWh, ndërsa në vitin 2023 ra në 6.36 TWh¹¹.

⁸ Zyra e Rregullatorit për Energji. Raporti Vjetor 2023. Burimi: [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/01.%20Raporti%20vjetor%202023_Final%20\(2\)%20-%20ANG.BA.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/01.%20Raporti%20vjetor%202023_Final%20(2)%20-%20ANG.BA.pdf)

⁹ Zyra e Rregullatorit për Energji. Raporti Vjetor 2023. Burimi: [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/01.%20Raporti%20vjetor%202023_Final%20\(2\)%20-%20ANG.BA.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/01.%20Raporti%20vjetor%202023_Final%20(2)%20-%20ANG.BA.pdf)

¹⁰ Zyra e Rregullatorit për Energji. Raporti Vjetor 2023. Burimi: [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/01.%20Raporti%20vjetor%202023_Final%20\(2\)%20-%20ANG.BA.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/01.%20Raporti%20vjetor%202023_Final%20(2)%20-%20ANG.BA.pdf)

¹¹ Zyra e Rregullatorit për Energji. Raporti Vjetor 2023. Burimi: [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/01.%20Raporti%20vjetor%202023_Final%20\(2\)%20-%20ANG.BA.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/01.%20Raporti%20vjetor%202023_Final%20(2)%20-%20ANG.BA.pdf)

Sipas Komunitetit të Energjisë, rreth 40% e familjeve në Kosovë përballen me varfëri energjetike. Shkaqet përfshijnë të ardhurat e ulëta, cilësinë e dobët të banesave, pajisjet elektro-energjetike joeficiente dhe vështirësinë për t'u përshtatur me ndryshimet në tarifat e energjisë. Kjo situatë çon në uljen e standardit të jetesës dhe pasoja negative për shëndetin e qytetarëve të prekur¹².

Në ndërmarrjen publike "Termokos", numri i konsumatorëve të pajisur me matës ka arritur në 143, kryesisht përdorues komercialë dhe institucionalë. Gjatë sezonit 2022/2023, faturimi u rrit me 1,209,796 € (16%) krahasuar me sezonin 2021/2022, duke arritur në një total prej 8,696,879 €. Nga kjo shumë, 33% (2,908,841 €) janë faturuar bazuar në matje, ndërsa 67% (5,788,038 €) janë faturuar pa matje¹⁵.

Gjatë sezonit 2022/2023, energjia termike e fituar nga kogjenerimi arriti në 308,156 MWhTH, duke shënuar një rritje prej 5% (13,783 MWhTH më shumë) krahasuar me sezonin e kaluar, i cili regjistroi 294,373 MWhTH¹³. Humbjet e energjisë termike në rrjetin e transmetimit të TC Kosova B dhe NQ Termokos gjatë periudhës tetor 2022 – prill 2023 ishin 6,136 MWhTH, ose rreth 2% me nivele të humbjeve që mbetën konsistente me ato të sezonit paraprak.¹⁴

Tabela 8: Konsumi i energjisë dhe Metrikat e Eficiencës: 2020–2022

Metrika	2020	2021	2022
Konsumi i energjisë	–	5,117 GWh	–
Konsumi primar i energjisë	–	2.8 tonnes	–
Konsumi final i energjisë	–	1.7 tonnes	–
Konsumi final i energjisë në familje (për kokë banori)	340 ktoe	–	–
Konsumi final i energjisë sipas produktit	–	–	1,486.983
Konsumi final i energjisë në familje sipas llojit të karburantit	–	–	555.070
Konsumi final i energjisë në transport sipas llojit të karburantit	–	–	430.051
Konsumi final i energjisë në industri sipas llojit të karburantit	–	–	19.359
Pjesa e energjisë së ripërtërishme në konsumin bruto final të energjisë (sektori)	–	–	2.351
Energy Intensity (in the region and EU)	–	–	EU: 107.42
Intensiteti i energjisë (në rajon dhe BE)			WB356.49 :6

¹² GIZ. Vlerësimi i ndikimit të varfërisë energjetike në grupet e cënueshme në Kosovë. 2022. Burimi: <https://www.giz.de/de/downloads/giz2023-en-factsheet-energy-poverty.pdf>

¹³ Zyra e Rregullatorit për Energji. Raporti Vjetor 2023. Burimi: [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/01.%20Raporti%20vjetor%202023_Final%20\(2\)%20-%20ANG.BA.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/01.%20Raporti%20vjetor%202023_Final%20(2)%20-%20ANG.BA.pdf)

¹⁴ Zyra e Rregullatorit për Energji. Raporti Vjetor 2023. Burimi: [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/01.%20Raporti%20vjetor%202023_Final%20\(2\)%20-%20ANG.BA.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/01.%20Raporti%20vjetor%202023_Final%20(2)%20-%20ANG.BA.pdf)

¹⁵ Zyra e Rregullatorit për Energji. Raporti Vjetor 2023. Burimi: [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/01.%20Raporti%20vjetor%202023_Final%20\(2\)%20-%20ANG.BA.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/01.%20Raporti%20vjetor%202023_Final%20(2)%20-%20ANG.BA.pdf)

Vlerësimi dhe rekomandimet e BGF-së

>Të dhëna të pamjaftueshme ose mungesë të tyre për modelet e konsumit të energjisë sipas sektorëve (familje, transport dhe industri).

>Mungesa e metrikeve për eficiencën energjetike në industri dhe ndërtesa.

>Mospërputhjet në të dhënat mbi eficiencën energjetike në Kosovë vijnë si pasojë e monitorimit të pamjaftueshëm, përdorimit të teknologjive të vjetruara dhe mungesës së raportimit sistematik në ndërtesa, industri dhe infrastrukturën publike.

>Të krijohet një kornizë e centralizuar për mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave specifike për sektorin e energjisë. Ky sistem duhet të gjurmtojë modelet e konsumit të energjisë në familje, transport dhe industri, për të mundësuar një vendimmarrje dhe zhvillim më të informuar të politikave.

>Krijimi dhe miratimi i metrikave të standardizuara për matjen e eficiencës së energjisë në industri, ndërtesa dhe infrastrukturën publike. Kjo do të ndihmojë në identifikimin e mundësive për kursimin e energjisë, vendosjen e standardeve dhe monitorimin e progresit drejt objektivave kombëtare të eficiencës së energjisë.

>Të investohet në teknologji moderne, si matësit inteligjentë dhe sistemet e menaxhimit të energjisë, për të përmirësuar saktësinë dhe shpeshtësinë e mbledhjes së të dhënave, dhe për t'i dhënë përparësi zbatimit në sektorë me konsum të lartë, si impiantet industriale dhe institucionet publike.

3.2 Klima

Përparimi i Kosovës në fushën e klimës dhe të dekarbonizimit ka qenë i kufizuar. Megjithatë, arritja kryesore ishte miratimi i Strategjisë së Energjisë 2022–2031, e cila përcakton objektiva ambicioze për tranzicionin energjetik të Kosovës. Strategjia përfshin objektivat e mëposhtëm:

> Rinovimi i termocentraleve: Do të rinovohen dy blloqe të termocentralit “Kosova B” dhe së paku një bllok i termocentralit “Kosova A”, me të cilën do të rritet kapaciteti prodhues për së paku 540 MW (ngarkesa bazë) dhe 360 MW (kapaciteti rezervë)..

> Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (Qëllimet e BRE-së deri në vitin 2031):

- Së paku 35% e konsumit të energjisë në Kosovë do të vijë nga burimet e ripërtërishme.
- 1600 MW energji nga BRE do të gjenerohet përmes termocentraleve të reja, duke përfshirë:
 - 600 MW nga era,
 - 600 MW nga dielli,
 - 20 MW nga biomasa,

– 100 MW nga përdoruesit vetëgjenerues.

Ndryshimet klimatike tashmë paraqesin një kërcënim për mjedisin, shëndetin e njerëzve dhe ekonominë, madje edhe në Kosovë. Ato po shkaktojnë gjithnjë e më shumë probleme për komunitetet, duke dëmtuar banesat, bizneset dhe bujqësinë. Është e domosdoshme të ndërmerren hapa për të luftuar ndryshimet klimatike, për të mbrojtur mjedisin, për të inkurajuar ekonomitë që të ndërtojnë një ekonomi me karbon të ulët dhe produktivitet të lartë, si dhe për të planifikuar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke siguruar që komunitetet të jenë të afta të përballen me to.

Parlamenti i Kosovës ka miratuar Ligjin e parë për Ndryshimet Klimatike në vitin 2024, duke paraparë një sërë aktiviteteve, përfshirë zhvillimin e një strategjie afatgjatë për dekarbonizimin dhe një sistem për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e emetimeve të GHG-ve.

Ligji i parë për Ndryshimet Klimatike ka për qëllim përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit dhe kontrollit të emetimeve të GHG-ve nga një gamë e gjerë burimesh, përfshirë industrinë, transportin, bujqësinë dhe sektorë të tjerë.

Ligji synon të identifikojë çështjet dhe sfidat për përmirësimin e legjislationit dytësor për ndryshimet klimatike, përmes transpozimit të legjislationit të Bashkimit Evropian, si dhe Rregullores për menaxhimin e Unionit Energjetik dhe masave klimatike. Ky proces do të bëhet duke marrë parasysh përkushtimin e Kosovës për të harmonizuar legjislationin e saj me BE-në dhe zbatimin e tij në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë tha se miratimi i ligjit është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të obligimeve të Kosovës për klimën, në përputhje me Rregulloren e adaptuar të qeverisjes, duke shtuar se elementët thelbësorë të rregullores janë reflektuar së bashku me angazhimin e Sekretariatit.

Megjithatë, është humbur një mundësi për të përfshirë të gjitha objektivat klimatike dhe energjetike të Komunitetit të Energjisë për vitin 2030, si dhe objektivin e neutralitetit klimatik për vitin 2050 në nivel kombëtar. Përfshirja e këtyre objektivave në ligjin kombëtar do të rriste më tej përkushtimin e Kosovës në luftën kundër ndryshimeve klimatike¹⁶.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës¹⁷, 75% e emetimeve të CO₂ në vitin 2020 kanë ardhur nga sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar. Ndotësit kryesorë të ajrit në vitin 2020 ishin:

- CO₂: 8,409 Gg,
- CH₄: 23.44 Gg,
- Bio CO₂: 3,338 Gg,
- N₂O: 1.99 Gg.

Sektorët me emetimet më të larta të CO₂ ishin:

- Sektori D (furnizimi me energji elektrike, gaz, avull, ajër të kondicionuar): 6,294 Gg (75% e totalit),
- Sektori C23 (produkte të tjera nga mineralet jometalike): 296.46 Gg,
- Sektori C24/C25 (prodhimi i metaleve bazë dhe produkteve metalike): 181.88 Gg.

Kosova ka përjetuar ndryshime në indikatorët e klimës midis viteve 2022 dhe 2023, siç pasqyrohet më poshtë:

Tabela 9: Indikatorët e klimës në Kosovë (2022–2023)

Indikator	2022	2023	Ndryshimi
Ditë me shi në Prishtinë	135 ditë	156 ditë	+15.6%
Temperatura mesatare maksimale (korrik)	30.5 °C	30.1 °C	- 0.4 °C
Temperatura mesatare maksimale vjetore	18.3 °C	18.9 °C	+0.6 °C
Temperatura mesatare minimale vjetore	6.1 °C	6.6 °C	+0.5 °C

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, <https://ihmk-rks.net/?page=2,3>

Këto rritje të temperaturës, të shoqëruara me reshje më të shumta, reflektojnë ndryshueshmërinë e vazhdueshme të klimës, duke paraqitur rreziqe për bujqësinë, infrastrukturën dhe shëndetin.

Në vitin 2022, 99.83% e popullsisë së Kosovës furnizohej me ujë përmes sistemit publik, të menaxhuar nga Kompanitë Rajonale të Ujit. Megjithatë, 0.17% e popullsisë ende nuk kishte qasje në shërbimet publike të ujit¹⁸.

Anketa për Mbeturinat Industriale e vitit 2022¹⁹ zbuloi se gjenerimi i mbeturinave industriale u rrit për 53.1% krahasuar me vitin 2021, duke arritur në 3,389,988 tonë.

Kontribuesit më të mëdhenj ishin:

- Sektori D (furnizimi me energji elektrike, gaz, avull, ajër të kondicionuar): 2,795,809 ton (rritje prej 120.5%),
- Sektori C (Prodhimi): 335,452 ton (rritje prej 3%).

Ndërkohë, sasia totale e mbeturinave të përpunuara në vitin 2022 ishte 3,390,096 ton, që është një rritje prej 53,2% krahasuar me vitin 2021.

Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) shënon një moment historik të rëndësishëm në përpjekjet e Kosovës për të integruar dhe harmonizuar politikat klimatike, energjetike dhe mjedisore²⁰. Kjo kornizë gjithëpërfshirëse shërben jo vetëm për të përmbledhur një sërë politikash ekzistuese, por gjithashtu vepron si një mekanizëm kyç për të siguruar që këto politika të jenë të përafruara drejt një qëllimi të unifikuar kombëtar.

¹⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Burimi: <https://ask.rks-gov.net/Releases/Details/7754>

¹⁸ Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit. Raporti Vjetor i Performancës për Kompanitë Rajonale të Ujësjetës në Kosovë. 2022. Burimi: https://www.arru-rks.org/assets/cms/uploads/files/Monitorimi%20i%20Performances/KRU-Raporti%20Vjetor%20i%20Performances%202022_Eng.pdf

¹⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Anketa mbi Mbeturinat Industriale. 2022. Burimi: <https://ask.rks-gov.net/Releases/Details/7739>

²⁰ Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës 2025–2030. Burimi: Sekretariati i Komunitetit të Energjisë

Në përputhje me këtë, qeveria ka miratuar **Strategjinë e Ndryshimeve Klimatike 2019–2028**²¹, e cila përfaqëson një hap thelbësor në menaxhimin e emetimeve të GHG-ve dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike gjatë dekadës së ardhshme. Strategjia përshkruan masat e zbutjes dhe përshtatjes që synojnë promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rritjen e reziliencës së Kosovës ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Emetimet e Kosovës janë rritur vazhdimisht²², duke paraqitur një sfidë për stabilitetin mjedisor dhe ekonomik të vendit.

– Emetimet totale të GHG në vitin 2008 ishin 9.5 Mt ekuivalent CO₂. Deri në vitin 2015, emetimet ishin rritur me 5.2%, duke arritur në 10 Mt ekuivalent CO₂, kryesisht të nxitura nga rritja e përdorimit të karburanteve fosile.

– Emetimet për kokë banori në vitin 2015 ishin 5,5 t CO₂, që është pak më shumë se gjysma e mesatares së BE-së prej 9,93 t CO₂. Megjithatë, emetimet për njësi të BPV-së ishin 0,56 kg CO₂ për EUR, pothuajse dyfish i mesatares së BE-së prej 0,4 kg CO₂ për EUR.

Këto statistika nxjerrin në pah sfidat ekonomike dhe sociale me të cilat përballet Kosova, e cila ka një nivel relativisht të ulët, por në rritje, të emetimeve, duke u kombinuar me një BPV më të ulët për kokë banori. Kjo situatë nënvizon rëndësinë e parimit të përgjegjësisë së përbashkët, por të diferencuar, siç përcaktohet në nenin 3.1 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC).

Kosova tashmë po ballafaqohet me efektet e ndryshimeve klimatike, ndërsa ndikimet e ardhshme pritet të përkeqësohen, duke përfshirë:

- Rritja e frekuencës së rreziqeve natyrore, si thatësirat, përmbytjet dhe zjarret pyjore, ndërsa ndryshimi i klimës intensifikohet.
- Temperaturat më të larta: pritet të sjellin valë më të shpeshta të të nxehtit dhe një rritje të zjarreve pyjore, një trend i dukshëm tashmë që nga viti 2000.
- Mungesa e ujit: për shkak të skemave më të pasigurta të reshjeve, zvogëlimit të rrjedhjeve dhe rritjes së kërkesës për burimet ujore, të cilat mund të përkeqësojnë rreziqet e thatësirës.
- Degradimi i ekosistemit: çon në reduktimin e shërbimeve të ekosistemit dhe humbjen e biodiversitetit.
- Kërcënimet e reja nga ndotja: duke përfshirë forma të reja të ndotjes dhe rritjen e sëmundjeve të lidhura me ujin.
- Kosova duhet të veprojë me urgjencë për të adresuar

këto rreziqe, duke zbatuar masa zbutëse, promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe përgatitur për ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Vlerësimi dhe rekomandimet e BGF-së:

- > Mungesa e vlerësimeve të cenueshmërisë për sektorë specifikë (bujqësia, uji dhe infrastruktura).
- > Mungesa e të dhënave historike dhe parashikimeve të ardhshme mbi rrezikun nga fatkeqësitë natyrore, si përmbytjet, thatësirat, etj.
- > Mungesa e një inventari të detajuar dhe të përditësuar në mënyrë të rregullt emetimet (për sektorë specifikë).
- > Mungesa ose të dhëna të kufizuara për emetimet nga sektorët më të vegjël (p.sh. menaxhimi i mbeturinave, ndryshimi i përdorimit të tokës).
- > Të kryhen vlerësime gjithëpërfshirëse për cenueshmërinë e sektorëve të bujqësisë, ujit dhe infrastrukturës për të identifikuar rreziqet specifike dhe për të përmirësuar planifikimin e qëndrueshmërisë sektoriale.
- > Krijimi i një sistemi kombëtar për menaxhimin e të dhënave të rrezikut nga fatkeqësitë, i cili do të mundësojë përpilimin, analizimin dhe përditësimin e rregullt të të dhënave historike dhe të parashikuara mbi përmbytjet, thatësirat dhe rreziqet e tjera natyrore.
- > Zhvillimi i një sistemi të centralizuar të specializuar për sektorin e inventarit të emetimeve, i cili përditësohet çdo vit për të ndjekur progresin dhe për të drejtuar strategjitë e synuara për reduktimin e emetimeve.
- > Zbatimi i kornizave të detyrueshme të raportimit dhe monitorimit për sektorët më të vegjël për të siguruar që emetimet e tyre regjistrohen me saktësi dhe integrohen në politikat kombëtare për klimën.

²¹ Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019–2028. Burimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=29356>

²² USAID. Emetimet e gazrave serë në Kosovë. 2017. Burimi: https://www.climate-links.org/sites/default/files/asset/document/2017_USAID_GHG%20Emissions%20Factsheet_Kosovo.pdf

3.3 Transporti

Mirëmbajtja e infrastrukturës, digjitalizimi dhe bashkëpunimi rajonal mbeten sfida kryesore në sektorin e infrastrukturës së Kosovës. Përderisa është shënuar një farë progresi, veçanërisht me krijimin e një organi hetimor kombëtar për transportin hekurudhor, shumica e përparimeve kanë ndodhur në transportin rrugor, me përqendrim të kufizuar ndaj hekurudhave. Në maj të vitit 2023, Kosova miratoi Strategjinë Multimodale të Transportit, e cila pritet të adresojë sfidat e lidhura me mënyrat e ndryshme të transportit²³.

Infrastruktura rrugore e Kosovës përfshin:

- 650 km rrugë primare,
- 1,310 km rrugë sekondare dhe
- 6,000 km rrugë lokale²⁴.

Nga ana tjetër, trafiku ajror po shënon një rritje të konsiderueshme. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës ka shënuar një rritje të numrit të udhëtarëve, nga 2.99 milionë në vitin 2022 në 3.42 milionë në vitin 2023.

Megjithatë, vëllimi i ngarkesave të transportuara mbetet relativisht i ulët, rreth gjysmë milioni ton²⁵.

Sa i përket regjistrimit të automjeteve, Kosova regjistroi 460,105 mjete motorike dhe jo-motorike në vitin 2023, duke reflektuar një rritje prej 9.3% krahasuar me vitin paraprak²⁶. Nga viti 2021 deri në vitin 2023, u importuan 585 automjete elektrike, duke sinjalizuar një zhvendosje drejt opsioneve më miqësore për mjedisin në sektorin e transportit²⁷.

Taksa ekologjike aktuale në Kosovë është 10 € për të gjitha automjetet dhe mbledhet si pjesë e procesit të regjistrimit vjetor. Megjithatë, për të mbështetur tranzicionin në transportin elektrik, Kosova duhet të mbledhë të dhëna më të detajuara mbi përdorimin e transportit publik, kapacitetin e infrastrukturës, fizibilitetin ekonomik dhe qëndrimet e publikut ndaj transportit të qëndrueshëm. Mbyllja e këtyre boshllëqeve në të dhëna do të ndihmojë në zhvillimin e politikave informuese dhe nxitjen e investimeve, në përputhje me qëllimet e dekarbonizimit dhe luftës kundër ndryshimeve klimatike të Kosovës.

Vlerësimi dhe rekomandimet e BGF-së:

>Ka mungesë të të dhënave të detajuara për përdorimin e transportit publik, kapacitetin e infrastrukturës, fizibilitetin ekonomik dhe qëndrimet e publikut, gjë që vështirëson planifikimin efektiv dhe investimin në zgjidhje të qëndrueshme për transport.

>Futja e stimujve të synuar, siç janë ulja e taksave ekologjike dhe subvencioneve për automjetet elektrike, për të përshpejtuar kalimin drejt lëvizshmërisë elektrike dhe për të zvogëluar varësinë nga karburantet fosile.

Tabela 10: Statistikat kryesore të transportit dhe automjeteve në Kosovë (2022–2023)

Viti	Mjetet motorike dhe jo-motorike të regjistruara	Rritja e regjistrimit të automjeteve (%)	Makina elektrike të importuara	Pasagjerë në Aeroportin e Prishtinës (milion)
2022	–	–	–	2.99
2023	460,105	%9.3	585	3.42

²³ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Strategjia Multimodale e Transportit 2023–2030. Burimi: https://mit-ks.net/repository/docs/2024_05_13_195148_STMM_SHQIP.pdf

²⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Burimi: https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__Transport__Annual%20indicators/tr06.px/

²⁵ Autoriteti i Aviacionit Civil. Burimi: <https://caa.rks-gov.net/category/statistika/>

²⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Burimi: <https://ask.rks-gov.net/Publication/Details/7882>

²⁷ Dogana e Kosovës. Burimi: <https://dogana.rks-gov.net/OpenData/Index?id=4>

3.4 Ekonomia qarkore

Kosova ka ndërmarrë një tranzicion ambicioz drejt një ekonomie qarkore, me qëllim të ruajtjes së mjedisit të saj natyror dhe biodiversitetit të pasur, të valorizimit të burimeve dhe talentit të saj dhe të kontribuimit në një ekonomi më reziliente dhe më rigjeneruese. Ky ndryshim synon gjithashtu të krijojë një shoqëri ku të gjithë kanë një mundësi për një jetë më cilësore.

Një moment historik i rëndësishëm në këtë rrugëtim ishte miratimi i **Udhërrëfyesit të Ekonomisë Qarkore**²⁸ në mars të vitit 2023, i cili hodhi themelet për një kuptim më të thellë të fuqive, aftësive dhe mundësive unike të Kosovës që mund të nxisin këtë transformim. Udhërrëfyesi krijon mundësinë që Kosova të lëvizë drejt një modeli ekonomik më të qëndrueshëm dhe qarkullues.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim²⁹ (SKZH) deri në vitin 2030 thekson qëllimin e zhvillimit të një ekonomie qarkore konkurruese, të integruar ndërkombëtarisht, të drejtuar nga inovacioni dhe digjitalizimi. Aktualisht, performanca ekonomike e Kosovës është e kufizuar, me një BPV për kokë banori prej 3,772 € dhe eksportet që përbëjnë vetëm 21.6% të BPV-së. Ekonomia gjithashtu karakterizohet nga një intensitet i lartë i CO₂ (0.47 kg CO₂ për njësi BPV-je të përshtatur sipas PPP-së), vlerë e ulët e shtuar bruto nga sektorët që lidhen me ekonominë qarkore (vetëm 0.8% e BPV-së) dhe përqindje e kufizuar e digjitalizimit, me një rezultat intensiteti prej 35.7, që është vetëm gjysma e mesatares së BE-së³⁰.

Sipas **Strategjisë për Zhvillimin Industrial dhe Mbështetjen e Biznesit deri në vitin 2030**³¹ synohet nxitja e rritjes së industrive të gjelbra. Një nga treguesit kryesorë është bruto vlera e shtuar në sektorët e ekonomisë qarkore, e cila në vitin 2020 arriti në 0.8% të BPV-së totale, me qëllimin për ta rritur në 1.0% deri në vitin 2026.

Vlerësimi dhe rekomandimet e BGF-së:

>Mungesa e të dhënave për iniciativat e angazhimit rinor dhe idetë e mbështetura të biznesit të gjelbër.

>Mungesa e të dhënave për emetimet e metanit nga deponitë dhe impiantet e trajtimit të mbeturinave.

>Mungesa e të dhënave për riciklimin, kompostimin dhe efikasitetin e menaxhimit të mbeturinave.

>Mungesa e të dhënave për investimet në infrastrukturën e ekonomisë qarkore dhe iniciativat për reduktimin e mbeturinave.

>Krijimi i një databaze të centralizuar për monitorimin dhe raportimin e iniciativave të gjelbra të udhëhequra nga të rinjtë, si dhe programeve mbështetëse për bizneset e gjelbra, duke siguruar një monitorim më të efektshëm dhe promovuar angazhimin e të rinjve.

>Zbatimi i një sistemi monitorimi të emetimeve të metanit për deponitë dhe impiantet e trajtimit të mbeturinave, me qëllim mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të sakta për emetimet, duke mbështetur përpjekjet e synuara për zbutjen e tyre.

>Të prezantohen kërkesat e standardizuara të raportimit për komunat dhe operatorët e menaxhimit të mbeturinave, duke mundësuar raportimin e rregullt të të dhënave mbi efikasitetin e riciklimit, kompostimit dhe menaxhimit të mbeturinave.

>Zhvillimi i një sistemi monitorimi për investimet, me qëllim përcjelljen dhe vlerësimin e financimeve dhe progresit në infrastrukturën e ekonomisë qarkore dhe në projektet për reduktimin e mbeturinave, duke mundësuar marrjen e vendimeve politike të bazuara në të dhëna..

²⁸ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Udhërrëfyesi I Kosovës për Ekonominë Qarkore. 2023. Burimi: https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DocumentsFiles/2023_8171e270-643b-4de3-9387-91794084eb8b.pdf

²⁹ Zyra e Kryeministrit. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030. Burimi: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/national-development-strategy-2030/>

³⁰ Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Strategjia për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030. Burimi: <https://mint.rks-gov.net/desk/inc/media/242E31B4-01F1-461C-A4FA-911B8E66E9BD.pdf>

³¹ Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Strategjia për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030. Burimi: <https://mint.rks-gov.net/desk/inc/media/242E31B4-01F1-461C-A4FA-911B8E66E9BD.pdf>

3.5 Përfshirja

Zbatimi i suksesshëm i Agjendës së Gjellbër mbështetet në përfshirjen aktive të grupeve të ndryshme të popullsisë, duke përfshirë të rinjtë, gratë dhe komunitetet e tjera të cënueshme. Fuqizimi i këtyre grupeve jo vetëm që forcon barazinë sociale, por gjithashtu rrit efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e nismave të gjelbra. Angazhimi i të rinjve është thelbësor për inovacionin, pasi ata sjellin perspektiva dhe energji të reja në përpjekjet për klimën. Programet arsimore, punëtoritë për zhvillimin e aftësive dhe platformat pjesëmarrëse duhet të kenë përparësi, me qëllim pajisjen e të rinjve me mjetet e duhura për të kontribuar në mënyrë domethënëse në Agjendën e Gjellbër.

Nëpërmjet programit RECONOMY, Helvetas po transformon në mënyrë aktive sektorin e ndërtimit duke promovuar teknologji me efikasitet energjetike dhe materiale ndërtimi miqësore ndaj mjedisit. Një nga iniciativat kryesore përfshin krijimin e Këshillave të Gjellbra të Ndërtimit, të cilët nxisin standardet e industrisë dhe krijojnë mundësi për punë të gjelbra për gratë dhe të rinjtë. Këto këshilla janë strukturuar sipas modeleve të suksesshme, si ai kroat, dhe ofrojnë shërbime të përcaktuara qartë për anëtarët e tyre, duke u përqendruar në aktivitete specifike. Duke marrë parasysh ndikimin e sektorit të ndërtimit në përdorimin e tokës, gjenerimin e mbeturinave dhe konsumin e energjisë, kjo iniciativë jo vetëm që përmirëson infrastrukturën e Kosovës, por gjithashtu kontribuon në orientimin e të gjithë rajonit drejt një ekonomie me karbon të ulët.

Helvetas ka investuar më tej në ndërtimin e një fuqie punëtore të kualifikuar për zgjerimin e sektorit të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë. Me rritjen e kërkesës për ekspertë të trajnuar në energjinë solare dhe të erës, që parashikohet të arrijë 25-30% në vit, Helvetas, përmes projektit të Rritjes së Punësimit të të Rinjve (EYE), në partneritet me ELING, lider në instalimet solare, ka krijuar programin e parë të trajnimit për instalimin e paneleve solare në vend. Ky program synon të rrisë diversitetin në sektorin e energjisë së ripërtëritshme, duke i pajisur pjesëmarrësit – veçanërisht gratë – me njohuri teorike dhe përvoja praktike. Projekti synon të trajtojë deri në 100 individë në vit, duke promovuar një fuqi punëtore gjithëpërfshirëse dhe të kualifikuar, e gatshme për të udhëhequr tranzicionin drejt energjisë së gjelbër në Kosovë³².

Ngjashëm, është thelbësore të promovohet barazia gjinore. Gratë shpesh luajnë një rol kyç në menaxhimin e burimeve natyrore, veçanërisht në sektorin e bujqësisë dhe në zonat rurale. Megjithatë, ato hasin në pengesa sistematike që kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në proceset e hartimit të politikave dhe të vendimmarrjes. Politikat gjithëpërfshirëse që mbështesin nismat e udhëhequra nga gratë dhe sigurojnë qasje në financa të gjelbra dhe

mundësi ndërmarrëse janë thelbësore për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm.

Së fundi, grupet e tjera të cënueshme, si ato që të prekura nga varfëria apo me aftësi të kufizuara duhet të përfshihen përmes ndërhyrjeve të fokusuara. Kjo mund të përfshijë qasje të përbalueshme në energjinë e ripërtëritshme, trajnime profesionale në sektorët e gjelbër dhe konsultime aktive mbi kornizat e politikave për të siguruar që askush të mos mbetet pas.

Vlerësimi dhe rekomandimet e BGF-së:

>Mungesa e të dhënave për përqindjet e pjesëmarrjes së të rinjve, grave dhe grupeve të cënueshme në iniciativat e ekonomisë së gjelbër, proceset e vendimmarrjes dhe aktivitetet e ndërmarrjes së gjelbër.

>Iniciativa të kufizuara që synojnë bizneset e menaxhuara nga gratë dhe inovacionet e drejtuara nga të rinjtë brenda sektorëve të ekonomisë së gjelbër, si energjia e ripërtëritshme, ekonomia qarkore dhe bujqësia e qëndrueshme.

>Mangësitë në programet arsimore dhe në ngritjen e kapaciteteve të krijuara posaçërisht për fuqizimin e këtyre grupeve dhe për t'i mundësuar atyre të kontribuojnë aktivisht në Agjendën e Gjellbër.

>Mekanizma mbështetës financiarë të pamjaftueshëm për grupet e marginalizuara për t'u përfshirë në teknologjitë e gjelbra ose për të nisur ndërmarrje të gjelbra.

>Zhvillimi i një kornize për mbledhjen e të dhënave për të ndjekur dhe raportuar në mënyrë sistematike pjesëmarrjen e të rinjve, grave dhe grupeve të cënueshme në iniciativat e ekonomisë së gjelbër, në proceset e vendimmarrjes dhe ndërmarrjes.

>Nisja e programeve të synuara që ofrojnë mbështetje teknike dhe financiare për bizneset e udhëhequra nga gratë dhe inovacionet e drejtuara nga të rinjtë në fushat e energjisë së ripërtëritshme, ekonomisë qarkore dhe bujqësisë së qëndrueshme.

>Hartimi dhe zbatimi i programeve të specializuara arsimore dhe zhvillimi i kapaciteteve që synojnë pajisjen e të rinjve, grave dhe grupeve të cënueshme me aftësitë e nevojshme për të kontribuar në Agjendën e Gjellbër.

>Krijimi i skemave të dedikuara të financave të gjelbra, të tilla si grante dhe kredi me interes të ulët, për t'u mundësuar grupeve të marginalizuara të adaptojnë teknologji të gjelbra dhe të hapin ndërmarrje të qëndrueshme.

³² HELVETAS, <https://www.helvetas.org/en/switzerland/how-you-can-help/follow-us/blog/sustainable-economy/building-a-greener-kosovo-a-path-to-sustainable-growth>

3.6 Menaxhimi i mbeturinave

Në gusht të vitit 2022, Kuvendi i Kosovës miratoi **Ligjin për Mbeturinat**³³, duke harmonizuar kornizën ligjore të vendit me Direktivat Evropiane për Menaxhimin e Mbeturinave. Megjithatë, zbatimi i këtij ligji ka qenë i ngadaltë. Pavarësisht ndikimit të rëndësishëm mjedisor, liqeni i depozitimit të hirit të thëngjillit i Kompanisë Energjetike të Kosovës dhe deponia e Mirashit në Obiliq vazhdojnë të mbeten funksionale.

Sipas raporteve nga komunat dhe operatorët e menaxhimit të mbeturinave³⁴, në vitin 2022 janë mbledhur 462,809,790 ton mbeturina. Duke u bazuar në popullsinë e shërbyer, shkalla kombëtare e gjenerimit të mbetjeve është llogaritur në 0.65 kg për kokë banori në ditë, ose 238.36 kg për kokë banori në vit. Kjo tregon një ulje krahasuar me 13.76 kg për kokë banori në vit, të raportuara në vitin 2021³⁵.

Në vitin 2022, sasia e mbeturinave të depozituara, krahasuar me vitin 2021, në totalin e të gjitha deponive ka shënuar një rritje prej 12,932.36 tonësh, ose një rritje prej 2.6%.

Në deponitë e menaxhuara nga KMDP, sasia e mbeturinave të depozituara për vitin 2022 ka arritur në 386,533.29 ton/vit, duke shënuar një rritje prej vetëm 2.8% krahasuar me vitin 2021.

Ndërkaq, në deponitë e tjera sanitare të menaxhuara nga KRM-të, sasia e mbeturinave të depozituara është 116,354.49 ton/vit, ose 2% më shumë krahasuar me vitin 2021.

Në total, sasia e mbeturinave komunale të depozituara në deponitë sanitare arrin në 502,887.72 ton/vit, duke shënuar një rritje prej rreth 2.6%, ose 12,932.19 ton më shumë krahasuar me vitin 2021³⁶.

Edhe pse ekzistojnë disa aktivitete të riciklimit në Kosovë, komunat nuk mund të ofrojnë të dhëna të sakta për shtrirjen e këtyre përpjekjeve. Kompanitë private janë të njohura për riciklimin e materialeve si najloni, plastika dhe metali, megjithatë, pjesa më e madhe e këtyre mbetjeve grumbullohen në mënyrë joformale, duke e bërë të vështirë vlerësimin e saktë të sasisë që riciklohet.

Vlerësimi dhe rekomandimet e BGF-së:

>Kosova nuk disponon të dhëna të detajuara mbi efikasitetin e përgjithshëm të sistemeve të menaxhimit të mbeturinave. Kjo përfshin informacion mbi proceset e grumbullimit, klasifikimit, trajtimit dhe asgjësimit, të cilat janë thelbësore për optimizimin e operacioneve dhe reduktimin e ndikimit mjedisor.

>Mungojnë të dhëna të detajuara për gjenerimin e mbeturinave të kategorizuara sipas familjeve, industrive dhe sektorëve të tjerë.

>Kosovës i mungojnë të dhënat gjithëpërfshirëse mbi gjenerimin, trajtimin dhe menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme.

>Të zbatohet një sistem kombëtar i monitorimit të menaxhimit të mbeturinave për ndjekjen dhe raportimin e të dhënave mbi proceset e grumbullimit, klasifikimit, trajtimit dhe asgjësimit, duke synuar përmirësimin e efikasitetit operativ dhe reduktimin e ndikimit mjedisor.

>Krijimi i një kornize sektoriale për raportimin e të dhënave mbi mbeturinat, me qëllim kategorizimin dhe analizimin e gjenerimit të mbeturinave nga familjet, industria dhe sektorë të tjerë, duke mundësuar hartimin e strategjive të synuara për reduktimin e mbeturinave.

>Zhvillimi i një sistemi për ndjekjen e mbeturinave të rrezikshme, i cili regjistron të dhëna mbi gjenerimin, trajtimin dhe asgjësimin e tyre, duke siguruar menaxhim të duhur dhe përputhshmëri me standardet e mbrojtjes së mjedisit.

³³ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ligji Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturinat. 2022. Burimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62435>

³⁴ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Raporti mbi Menaxhimin e Mbeturinave Komunale në Kosovë. 2024. Burimi: <https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/REPORT%20OF%20THE%20MUNICIPAL%20WASTE%202022.pdf>

³⁵ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Raporti mbi Menaxhimin e Mbeturinave Komunale në Kosovë. 2024. Burimi: <https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/REPORT%20OF%20THE%20MUNICIPAL%20WASTE%202022.pdf>

³⁶ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Raporti mbi Menaxhimin e Mbeturinave Komunale në Kosovë. Burimi: <https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/REPORT%20OF%20THE%20MUNICIPAL%20WASTE%202022.pdf>

3.7 Uji

Hidrografia e Kosovës përfaqëson një burim të çmuar natyror, i përbërë nga ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore. Përbërja gjeologjike e tokës dhe struktura gjeografike luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e shpërndarjes natyrore të rrjetit hidrografik. Kosova mbart një rrjet të larmishëm lumenjsh, të mëdhenj dhe të vegjël, si dhe rezervuarë uji, si natyrorë ashtu edhe artificialë.

Megjithatë, burimet ujore janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë në të gjithë territorin. Studimet tregojnë se Rrafshi i Dukagjinit ka burime më të pasura ujore në krahasim me rajonet e tjera.

Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU) dallojnë në mbulimin dhe cilësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë³⁷, siç tregohet në tabelën e mëposhtme.

pandryshuar në shumicën e KRU-ve, përveç KRU-së "Prishtina". Kompanitë "Hidrodrini" dhe "Hidromorava" kanë nivele veçanërisht të ulëta shërbimi, çka tregon nevojë të konsiderueshme për përmirësim, ndërsa KRU "Prishtina" dhe "Bifurkacioni" tregojnë shkallë më të lartë të mbulimit, përkatësisht mbi 79% dhe 74%³⁹.

Përqendrimet e ortofosfatit u përcaktuan në nivele të konsiderueshme, veçanërisht në lumin Sitnicë, në dy lokacione ku u morën mostrat. Përqendrimi më i lartë u regjistrua në fshatin Hallaq gjatë vjeshtës, me një vlerë prej 1.42 mg/L P-PO₄. Gjatë pranverës, lumi Mirusha shfaqti përqendrimet më të larta të ortofosfatit, duke arritur një vlerë prej 1.36 mg/L. Lumbardhi në Prizren tregoi vlerat më të larta të BOD₅, me 62.6 mg/L në pranverë dhe 102.5 mg/L në vjeshtë. Në mënyrë të ngjashme, lumi Mirusha në Gjiilan regjistroi nivele të larta të BOD₅, me 53.6 mg/L gjatë pranverës dhe 115 mg/L gjatë vjeshtës⁴⁰.

Tablela 11: Mbulimi i ujësjellësve dhe kanalizimeve nga KRU-të

KRU	Mbulimi i furnizimit me ujë	Mbulimi i kanalizimeve
Gjakova	99%	-
Prishtina	83%	79%
Peja	85%	-
Hidromorava	61%	-
Hidroregjioni Jugor	66%	-
Bifurkacioni	-	74%
Hidrodrini	-	-

Gjendja e infrastrukturës së kanalizimeve në Kosovë mbetet e papërshtatshme, me 35% të popullsisë ende jo të kyçur në sistem³⁸. Nga 156.8 milionë metra kub ujë të shpërndarë nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU), rreth 75% derdhet i patrajtuar në lumenj, duke paraqitur një kërcënim serioz si për mjedisin ashtu edhe për shëndetin publik. Shërbimi i mbulimit me kanalizim ka ngecur, me vetëm 65% të popullsisë që përfiton nga këto shërbime. Shkalla e mbulimit ka mbetur e

Në vitin 2019, konsumi i ujit në amvisëri arriti në 49,014,648 metra kub, ndërsa institucionet konsumuan 6,922,027 metra kub. Konsumi i ujit për ujitje u vlerësua në rreth 70 milionë metra kub. Ndërmarrjet e mëdha industriale, të cilat përdorin ujin për procese teknologjike, ftohje, kanalizime dhe nevoja të tjera, përfaqësojnë më shumë se 30% të konsumit të përgjithshëm të ujit në Kosovë⁴¹.

37 Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit. Raporti Vjetor i Performancës për Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit në Kosovë. – 2022. 2023. Burimi: https://www.arru-rks.org/assets/cms/uploads/files/Monitorimi%20i%20Performances/KRU-Raporti%20Vjetor%20i%20Peformances%202022_Eng.pdf

38 Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit. Raporti Vjetor i Performancës për Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit në Kosovë. – 2022. 2023. Burimi: https://www.arru-rks.org/assets/cms/uploads/files/Monitorimi%20i%20Performances/KRU-Raporti%20Vjetor%20i%20Peformances%202022_Eng.pdf

39 Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit. Raporti Vjetor i Performancës për Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit në Kosovë – 2022. 2023. Burimi: https://www.arru-rks.org/assets/cms/uploads/files/Monitorimi%20i%20Performances/KRU-Raporti%20Vjetor%20i%20Peformances%202022_Eng.pdf

40 Let's Do It Peja. Cilësia e Ujërave Sipërfaqësore në 4 Pellgjet Lumore në Kosovë – Zona të Sinjalizuara nga Komuniteti. 2023.

41 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Gjendja e Ujërave në Kosovë. 2020. Burimi: [https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/ANGLISHT_WEB_uji\(1\).pdf](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/ANGLISHT_WEB_uji(1).pdf)

Kosova ende nuk ka zhvilluar një sistem gjithëpërfshirës për trajtimin e ujërave të zeza, megjithëse impiantet për trajtimin e tyre janë aktualisht në ndërtim. Sipas Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit (ARRU), shërbimet e grumbullimit të ujërave të zeza në zonat e mbuluara nga KRU-të përfshinin 65% të popullsisë në vitin 2022⁴².

Vlerësimi dhe rekomandimet e BGF-së:

>Mangësitë në monitorimin e detajuar të burimeve të ndotjes së ujit, si industria, transporti, amvisëria dhe përdorimi i energjisë.

>Mungesa e të dhënave mbi cilësinë e ujit, nivelet e ndotjes dhe burimet e ndotjes së ujit.

>Mungesa e të dhënave mbi ndotjen e tokës, veçanërisht në sektorët e bujqësisë dhe industrisë, ndikon si në shëndetin publik ashtu edhe në produktivitetin bujqësor.

>Krijimi i një rrjeti të integruar për monitorimin e cilësisë së ujit, i cili ndjek ndotjen nga industria, transporti, amvisëritë dhe burimet e energjisë, me qëllim hartimin e strategjive të synuara për zbutjen e saj.

>Zbatimi i një sistemi gjithëpërfshirës për monitorimin e cilësisë së ujit, i cili vlerëson rregullisht nivelet e ndotjes dhe identifikon burimet e saj, synon përmirësimin e menaxhimit të burimeve ujore dhe shëndetit publik.

>Kryerja e vlerësimeve të rregullta të ndotjes së tokës në zonat bujqësore dhe industriale, me qëllim monitorimin e niveleve të ndotjes dhe informimin e politikave që mbrojnë shëndetin publik dhe rrisin produktivitetin bujqësor.

⁴² Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit. 2023. Burimi: <https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/ANNUAL%20REPORT%20on%20the%20State%20of%20the%20Environment%202022%20ENG%20-%20Final.pdf>

3.8 Sistemet e qëndrueshme ushqimore dhe zonat rurale

Sistemi ushqimor përfshin "zinxhirët e aktiviteteve tregtare dhe jotregtare, si dhe akterët e përfshirë në prodhimin, mbledhjen, transportin, ruajtjen, përpunimin, furnizimin, shpërndarjen, përgatitjen dhe konsumin e ushqimit".

Një nga sfidat kryesore të dekadës së fundit ka qenë transformimi i sistemeve ushqimore konvencionale në sisteme të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Kjo sfidë mbetet e rëndësishme edhe për Kosovën, ku sistemi ushqimor përballlet me një sërë pengesash, si mungesa e monitorimit efektiv të prodhimit të ushqimit, përhapja e ushqimeve shumë të përpunuara që nuk mbështesin një dietë të shëndetshme dhe ushqyese, si dhe menaxhimi joefikas i mbetjeve ushqimore⁴³.

Vlerësimi dhe rekomandimet e BGF-së:

>Sistemet e pamjaftueshme për ndjekjen dhe monitorimin e proceseve të prodhimit të ushqimit pengojnë aftësinë për të garantuar sigurinë, cilësinë dhe qëndrueshmërinë e ushqimit përgjatë gjithë zinxhirit të furnizimit.

>Konsumimi i gjerë i ushqimeve shumë të përpunuara kontribuon në shprehi të këqija dietike, duke kufizuar qasjen në dieta të shëndetshme dhe të pasura me vlera ushqyese.

>Infrastruktura dhe strategjitë e kufizuara për menaxhimin e mbeturinave ushqimore çon në joefikasitet, ndikime negative mjedisore dhe humbjen e mundësive për rikuperimin dhe rishpërndarjen e burimeve.

>Zbatimi i një sistemi të centralizuar për monitorimin e prodhimit të ushqimit, duke siguruar cilësinë, sigurinë dhe qëndrueshmërinë nga ferma te tryeza.

>Lansimi i fushatave ndërgjegjësuëse dhe ofrimi i stimujve politikë për të nxitur prodhimin dhe konsumin e

ushqimeve të përpunuara minimalisht dhe me vlera të larta ushqyese.

>Krijimi i programeve për reduktimin, riciklimin dhe rishpërndarjen e mbetjeve ushqimore përmes partneriteteve publike-private, me qëllim minimizimin e ndikimeve mjedisore dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë ushqimore.

3.9 Bujqësia

Bujqësia luan një rol jetik në Kosovë, veçanërisht për popullsinë rurale. Më shumë se gjysma e tokës bujqësore të Kosovës kontribuon në sigurimin e ushqimit dhe punësimit për komunitetet rurale, kryesisht përmes parcelave të vogla familjare që përdoren kryesisht për nevojat e tyre⁴⁴.

Bujqësia kontribuon me 7.4% në BPV-në e Kosovës, që përkthehet në 658 milionë euro. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2022, sipërfaqja totale e shfrytëzuar për bujqësi ishte 420,482 hektarë⁴⁵. Pjesën më të madhe të kësaj sipërfaqeje, 51.6%, e zënë livadhet dhe kullosat, ndërsa 44.8% përbëhet nga toka e punueshme. Ndërkohë, kopshtet, plantacionet, vreshtat dhe fidanishtet përfaqësojnë 3.6% të sipërfaqes totale (15,079 hektarë)⁴⁶.

Në vitin 2022, prodhimi bimor u vlerësua në 654 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 23% krahasuar me vitin 2021 (532 milionë euro). Kjo rritje u stimulua nga shtimi i vlerës së drithërave, bimëve foragjere, perimeve, produkteve të kopshtarisë, i pemëve frutore dhe patateve. Nga ana tjetër, produktet blegtorale arritën një vlerë prej 315 milionë eurosh, duke paraqitur një rritje prej 14% krahasuar me vitin 2021 (277 milionë euro)⁴⁷.

ORGANIKA, shoqata e vetme në Kosovë që mbështet anëtarët e saj në marrjen e certifikimit organik, u themelua në vitin 2013 dhe aktualisht numëron 32 anëtarë, ndër të cilët 28 janë kompani të certifikuara organike⁴⁸. Shumica e produkteve të certifikuara organike të Kosovës përbëhen nga produkte pyjore jo-

⁴³ INDEP. Sistemi ushqimor i Kosovës: Qëndrueshmëria e tij dhe politikat që mungojnë. 2021. https://indep.info/wp-content/uploads/2021/11/INDEP_KAS_Sistemi-ushqimor-i-Kosoves-ENG.pdf

⁴⁴ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Raporti i Gjellbër 2023. Burimi: https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf

⁴⁵ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Bujqësia e Kosovës në numra. 2023. https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Kosovo_Agriculture_in_numbers_2023.pdf

⁴⁶ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Bujqësia e Kosovës në numra. 2023. https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Kosovo_Agriculture_in_numbers_2023.pdf

⁴⁷ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Bujqësia e Kosovës në numra. 2023. https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Kosovo_Agriculture_in_numbers_2023.pdf

⁴⁸ Organika. Burimi: <https://organika-ks.org/en/home/>

drusore (NPFP)⁴⁹. Eksportet kryesore janë mallra gjysmë të përpunuara ose lëndë të para, ndërsa vetëm 9% e produkteve organike eksportohen si mallra plotësisht të përpunuara dhe të paketuara, të gatshme për konsum nga përdoruesit fundorë. Plehurat dhe përmirësuesit e tokës përbëjnë 12% të eksporteve organike⁵⁰.

Ndërmjet viteve 2016 dhe 2022, 833,326 hektarë tokë bujqësore u trajtuan me pesticide⁵¹. Në vitin 2019, bujqësia përbënte 8% të emetimeve totale të GHG-së (ekuivalente me 706 mijë tonë CO₂)⁵². Kontribuesit kryesorë të këtyre emetimeve në vitin 2019 ishin:

- > Fermentimi enterik (proceset e tretjes së kafshëve) – 67%;
- > Emetimet nga menaxhimi i plehurat organik të kafshëve – 10%, dhe
- > Emetimet nga menaxhimi i tokës – 12%.

Vlerësimi dhe rekomandimet e BGF-së:

- > Mungesa e të dhënave për digjitalizimin e parcelave dhe kategorizimin e tokave.
- > Mungesa e të dhënave për programet që mbështesin inovacionin në bujqësinë urbane, promovimin e produkteve të gjelbra me intensitet të ulët të karbonit dhe përfshirjen e anëtarëve të komunitetit që kanë mbetur pas.
- > Mungesa e të dhënave për përqindjen e grave pronarë ose mbajtëse të të drejtave mbi tokën bujqësore, sipas llojit të pronësisë (%).
- > Agroekologjia si koncept duhet të integrohet në kuadër të kornizës së politikave.
- > Zhvillimi i një sistemi kombëtar digjital të regjistrave të tokës për hartëzimin, kategorizimin dhe menaxhimin e parcelave të tokës, me synimin për të rritur transparencën dhe efikasitetin në planifikimin e përdorimit të saj.

> Krijimi i një databaze të centralizuar për përcjelljen dhe vlerësimin e programeve që mbështesin bujqësinë urbane, produktet e gjelbra me karbon të ulët, dhe përfshirjen e grupeve të marginalizuara, duke mundësuar hartimin dhe monitorimin më të efektshëm të këtyre programeve.

> Të realizohet një anketë kombëtare për të mbledhur të dhëna të ndara sipas gjinisë mbi pronësinë dhe përdorimin e tokës, duke siguruar zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse gjinore në sektorin e bujqësisë.

> Të përfshihen parimet e agro-ekologjike në politikat kombëtare bujqësore për të promovuar praktika të qëndrueshme bujqësore, ruajtjen e biodiversitetit dhe për të qenë rezilient ndaj ndryshimeve klimatike.

3.10 Biodiversiteti

Kosova, përkundër sipërfaqes së vogël, mund të mburret me një biodiversitet të pasur. Pozicioni i saj gjeografik, faktorët gjeologjikë, hidrologjia dhe klima kontribuojnë në ekosistemin e saj të larmishëm biologjik, i cili përfshin një gamë të gjerë flore, faune dhe vegjetacioni, si dhe specie relikte, endemike dhe të tjera të rëndësishme.

Sipas studimeve të ndryshme⁵³, Kosova është shtëpia e më shumë se 3000 llojeve të florës vaskulare. Gjithashtu, janë identifikuar 223 lloje kërpudhash, të shpërndara në 143 gjini dhe 43 familje.

Për sa i përket faunës, hulumtimit dhe literaturës vërehet se Kosova është e banuar nga mbi 300 lloje vertebrorë të egra, duke përfshirë:

- Mbi 30 lloje peshqish,
- Mbi 20 lloje amfibësh,
- Mbi 25 lloje zvarranikësh,
- Mbi 200 lloje zogjsh, dhe
- Mbi 100 lloje gjitarësh.⁵⁴

Sipas Inventarit Kombëtar të Pyjeve (IKP), të kryer në vitin 2012, pyjet e Kosovës u rritën me 5% ndërmjet viteve 2002–2012, duke arritur një sipërfaqe prej 481.000 hektarësh (44.7% e sipërfaqes totale të tokës së

⁴⁹ Ekoconnect. Raport mbi Statusin e Bujqësisë Organike dhe Industrisë në Kosovë. 2022. Burimi: http://www.ekoconnect.org/tl_files/eko/p/Projekte/MOE-Laenderberichte/Country-Report-Organic-KOSOVO-EkoConnect-2022.pdf

⁵⁰ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Raporti i Gjelbër 2023. Burimi: https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf

⁵¹ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Raporti i Gjelbër 2023. Burimi: https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf

⁵² Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Raporti i Gjelbër 2023. Burimi: https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Green_Report_2023.pdf

⁵³ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Raporti për gjendjen e natyrës 2018–2021. Burimi: <https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/RAPORTI%20PER%20GJENDJEN%20E%20NATYRES%202018%20-%202021%20ALB.pdf>

⁵⁴ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Raporti për gjendjen e natyrës 2018–2021. Burimi: <https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/RAPORTI%20PER%20GJENDJEN%20E%20NATYRES%202018%20-%202021%20ALB.pdf>

Kosovës). Sa i përket pronësisë, 62% e pyjeve janë në pronësi shtetërore, ndërsa pjesa tjetër i përket pronarëve privatë. Mbulimi pyjor në Kosovë është më i lartë krahasuar me vendet fqinje: Shqipëria (28%), Maqedonia e Veriut (39%), Mali i Zi (40%) dhe Serbia (31%). Gjatë vitit 2021 u regjistruan 87 zjarre pyjore në pyje publike dhe private, të cilat prekën një sipërfaqe prej rreth 2653 hektarësh⁵⁵.

Kosova gjithashtu po ndërmerr hapa të rëndësishëm drejt mbrojtjes së natyrës. Që nga viti 2022 në vend janë identifikuar 260 zona të mbrojtura, të cilat mbulojnë gjithsej 126,115.8 hektarë, ose 11.6% të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës⁵⁶.

Biodiversiteti i Kosovës është i pasur, por përballët me disa sfida urgjente:

- 1.** Shpyllëzimi – Prerjet e paligjshme dhe përpjekjet e pamjaftueshme për ripyllëzim kontribuojnë në humbjen e habitatit, erozionin e tokës dhe uljen e kapacitetit për kapjen e karbonit. Kjo situatë përkeqësohet nga zbatimi i pamjaftueshëm i ligjeve për mbrojtjen e pyjeve.
- 2.** 2Speciet dhe habitatet e rrezikuara – Të dhënat mbi speciet e rrezikuara janë të kufizuara, duke e vështirësuar planifikimin dhe zbatimin e përpjekjeve për ruajtjen e tyre. Disa lloje endemike, si rrëqebulli i Ballkanit, ndodhen në rrezik të lartë për shkak të fragmentimit dhe degradimit të habitateve.
- 3.** Boshllëqet ligjore – Mungesa e legjislacionit të përditësuar që adreson nevojat bashkëkohore për mbrojtjen e mjedisit kufizon aftësinë për të mbrojtur në mënyrë efektive biodiversitetin.

Vlerësimi dhe rekomandimet e BGF-së:

- >Mungesa e të dhënave sistematike për mbrojtjen e specieve, specieve të rrezikuara dhe habitatet e rrezikuara.
- >Mungesa e të dhënave për projektet e vazhdueshme të ruajtjes dhe për efektivitetin e tyre në restaurimin e ekosistemit.
- >Zhvillimi dhe implementimi i një plani kombëtar për të zbutur shpyllëzimin, duke përfshirë dënime më të rrepta për prerjet ilegale të pyjeve.
- >Të realizohet një regjistrim kombëtar i biodiversitetit për të identifikuar speciet e rrezikuara dhe habitatet kritike.

⁵⁵ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Politikat dhe Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2022–2030. 2021. Burimi: https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Policy_strategy_on_forestry_dev_in_Kosovo_2022_2030.pdf

⁵⁶ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Politikat dhe Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2022–2030. 2021. Burimi: https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Policy_strategy_on_forestry_dev_in_Kosovo_2022_2030.pdf

4. Konkluzionet

Ky raport thekson progresin e bërë nga Kosova në avancimin e Agjendës së Gjelbër të Ballkanit Perëndimor, një kornizë kyçe e krijuar për të adresuar ndryshimet klimatike, tranzicionin energjetik dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Pavarësisht progresit të Kosovës në miratimin e politikave dhe kornizave ligjore të përafruara me standardet evropiane, raporti identifikon një sërë sfidash që pengojnë avancimin e mëtejshëm.

Arritjet kryesore përfshijnë përshtatjen e Strategjisë së Energjisë 2022-2031, e cila fokusohet në rritjen e kapaciteteve të energjisë së ripërtërishme, përmirësimin e efikasitetit energjetik dhe reduktimin e emetimeve të GHG-së. Kosova gjithashtu ka shënuar përparim në menaxhimin e mbeturinave, iniciativat e ekonomisë qarkore dhe mbrojtjen e biodiversitetit. Zhvillimi i projekteve të energjisë së ripërtërishme, si energjia solare dhe energjia e erës, si dhe miratimi i Strategjisë për Ndryshimet Klimatike 2019-2028, përbëjnë hapa të rëndësishëm drejt rritjes së qëndrueshmërisë ndaj klimës.

Megjithatë, raporti thekson boshllëqet kritike, veçanërisht në fushat e vlerësimeve të cënueshmërisë specifike për sektorë, infrastrukturës së menaxhimit të mbeturinave, monitorimit të cilësisë së ujit dhe kontrollit të ndotjes së ajrit. Të dhënat e pamjaftueshme për emetimet dhe konsumin e energjisë në sektorë të ndryshëm, së bashku me teknologjitë dhe infrastrukturën e vjetruar, përbëjnë barrierë shtesë. Mbështetja në termocentralet me linjit dhe sistemet joefikase të ngrohjes kontribuon ndjeshëm në emetimet e GHG-ve dhe ndotjen e ajrit në Kosovë, duke kërkuar vëmendje dhe investime urgjente.

Për të siguruar zbatimin e suksesshëm të Agjendës së Gjelbër, Kosova duhet të forcojë bashkëpunimin ndërsektorial, të përmirësojë sistemet e grumbullimit dhe monitorimit të të dhënave, si dhe të përshpejtojë adaptimin e teknologjive më të pastra. Adresimi i këtyre sfidave jo vetëm që do të forcojë mbrojtjen e mjedisit, por gjithashtu do ta pozicionojë Kosovën si një lider rajonal në zhvillimin e qëndrueshëm. Në raport konkludohet se investimet e vazhdueshme në energjinë e ripërtërishme, modernizimin e infrastrukturës dhe fushatat për ndërgjegjësimin e publikut do të jenë thelbësore për arritjen e qëllimeve afatgjata të qëndrueshmërisë së Kosovës.

